

TIPOLOGJI TË FINANCIMIT TË TERRORIZMIT DHE ARMËVE TË SHKATËRRIMIT NË MASË


DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

NËNTOR 2020

Dokument i publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, bazuar në çështje të investiguara në nivel ndërkombëtar për përfshirje të personave, kompanive dhe vëndeve të ndryshme në aktivitete që lidhen me financimin e terrorizmit dhe financimin e armëve të shkatërrimit në masë.


Tipologji nr.1 *Financimi i terrorizmit nëpërmjet transfertave nga një aktivitet biznesi i ligjshëm*

Një biznes i ligjshëm përdoret për të transferuar para tek individë që kanë lidhje me terrorizmin. Dyshimet e autoriteteve të zbatimit të ligjit u bazuan në faktin se fondet e përdorura janë më të mëdha se veprimtaria normale e biznesit. Në skemën në vijim paraqiten lidhjet mes palëve, përdorimi i llogarive bankare dhe përfshirja e biznesit të ligjshëm.




Tipologji Nr. 2 *Fonde që rrjedhin nga aktivitet bamirësie që përdoren për financim të terrorizmit.*

Një organizatë jofitimprurëse përdoret për të mbledhur fonde dhe një kompani fictive (guackë) që më pas përdoret për transferimin e ketyre fondeve në drejtim të grupeve terroriste që veprojnë në një vënd që gjendet në një rajon konflikti ndërkombëtar.




Tipologji Nr. 3 *Përdorimi nga organizata terroriste i fondeve të jashtëligjshme*

Nga hetimet e ndërmarra nga organet kompetente në këtë rast organizata terroriste financohet nëpërmjet të ardhurave nga veprimtari kriminale.




Tipologji nr. 4 *Financimi i terrorizmit nëpërmjet fondeve me burim të ligjshëm*

Financimi i terrorizmit në këtë rast, mundësohet nëpërmjet transfertave në shuma të vogla, nga burime të ligjshme nëpërmjet llogarive bankare, të cilat më pas përdoren për blerje materiale për ndërtimin e bombave.




Tipologji nr. 5 Përdorimi i kompanive fiktive (guackë) për transferimin e fondeve.

Kompanitë guackë që ndodhen në dy vende të ndryshme, janë përdorur për transferimin e fondeve pa dhënë holësi në lidhje me qëllimin në dy vende të ndryshme dhe janë dhënë detaje të paqarta lidhur me arsyen e këtyre transaksioneve apo burimin e fondeve.



Tipologji nr. 6 *Pagesa nëpërmjet një institucioni financiar.*


Në këtë rast një institucioni financiar, i është kërkuar të kryejë një pagesë, për një kompani të regjistruar në një adresë false, në një shtet me një vënd që është subjekt sanksionesh ndërkombëtare.



Tipologji nr. 1 *Kompani fasadë të përfshirë në kamuflimin e transfertave ndërkombëtare.*


Një komisioner për shitjen e titujve, me shtetësi të dyfishtë të një vëndi të BE dhe Iranit, përdor një kompani fasadë, të regjistruar në Ishujt Britanik (*British Virgin Islands*) e cila disponon llogari të shumta bankare.

Kompania përdoret për të fshehur gjurmët e transfertave dhe transaksioneve që kryhen në vënde të ndryshme, në mënyrë që të shmangë vëmëndjen e institucioneve financiare dhe autoriteteve kompetente në fushën e parandalimit të financimit të armëve të shkatërrimit në masë.




Tipologji nr. 2 Blerja e mallrave me përdorim të dyfishtë.

Nëpërmjet transaksioneve të shumta bankare që kryhen me kompani në disa vënde të botës, mundësohet blerja e mallrave me përdorim të dyfishtë, të cilat më pas do të dërgohen nga Holanda drejt kompanive në Iran, të përfshira në programin nuklear.




Tipologji nr. 3 *Transaksione mes bankave dhe një kompanie subjekt sanksionesh*

Përfshirja e dy bankave dhe një kompanie të cilat janë subjekt regjimesh sanksionesh të ndryshme. Kompania kryen transaksione që në pamje të parë janë në përputhje me aktivitetin e saj.




Tipologji nr. 4 *Shmangia nga efektet e sanksioneve kundër financimit të armëve të shkatërrimit në masë*

Në këtë rast një firmë ekspertësh kontabël përdoret për të kryer transaksione që synojnë të mënjanojnë pasojat e sanksioneve për veprimtaritë që lidhen me financimin e armëve të shkatërrimit në masë.



Tipologji nr. 5 Blerja e mallrave me përdorim të dyfishtë.

Në këtë rast një kompani në Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA), mundëson kryerjen e blerjes së mallrave me përdorim të dyfishtë për Iranin.



Tipologji nr. 6 *Proces prokurimi që përfshi një rrjet të qëndrueshëm dhe të konsoliduar zyrash këmbimi valutë*

Shërbimet financiare të një rrjeti zyrash këmbimi valutë dhe marrëdhëniet e saj korespondente në Shtetet e Bashkuara, përdoren për të mundësuar prokurimin e mallrave për një kompani Iraniane.

